



*Empowered lives.  
Resilient nations.*

# **Studim mbi edukimin dhe motivimin e votuesve në prag të zgjedhjeve vendore të qershorit 2015 në Shqipëri**

***Përgatitur nga: Partnerët Shqipëri***



**Partnerët Shqipëri  
Qendra për Ndryshim  
dhe Manaxhim Konflikti**

***Prill 2015***

*Ky raport është përgatitur me mbështetjen e Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Shqipëri.*

*Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP).*

## ***Tabela e Përmbajtjes***

I.	OBJEKTIVAT E STUDIMIT .....	4
II.	METODOLOGJIA .....	4
III.	PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE.....	5
	a. Ndërgjegjësimi mbi çështjet kryesore zgjedhore dhe qytetare.....	5
	b. Motivimi për të votuar dhe për të mbështetur kandidatët apo partitë .....	6
	c. Ndikimet në motivimin dhe sjelljen e votuesve lidhur me Reformën Administrative Territoriale ..	6
IV.	GJETJET DHE ANALIZA E PLOTË .....	7
	a. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i përgjithshëm i votuesve .....	7
	b. Motivimi për votim dhe mbështetjen e një kandidati apo partie .....	10
	c. Influencat në sjelljen e votuesve që rezultojnë nga Reforma Administrative Territoriale .....	12
V.	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....	15
	a. Ndërgjegjësimi mbi çështjet thelbësore të zgjedhjeve.....	15
	b. Edukimi i përgjithshëm qytetar dhe i votuesve .....	15
	c. Motivimi për të votuar.....	16
	d. Ndikimet e Reformës Administrative Territoriale në motivimin e votuesve .....	16

## I. OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Zgjedhjet për pushtetin vendor do të zhvillohen në Shqipëri në 21 qershor 2015. Këto zgjedhje do të jenë ndryshe nga zgjedhjet e mëparshme për faktin se qytetarët do të votojnë në 61 bashki të reja, si për Kryetarin e Bashkisë ashtu edhe për Këshillin Bashkiak.<sup>1</sup> UNDP, si pjesë e projektit të tij për Fuqizimin e Proceseve Elektorale në Shqipëri (FPESH), inicioi këtë studim për të identifikuar nevojat më të rëndësishme të qytetarëve për informacion dhe edukim në muajt e fundit përpara Ditës së Zgjedhjeve.

Në fillim të muajit prill u organizuan në rajone të ndryshme të vendit diskutime në grupe të fokusuara, me pjesëmarrjen e qytetarëve në moshë për të votuar.<sup>2</sup> Diskutimet synuan të eksplorojnë çështje të përgjithshme lidhur me edukimin dhe ndërgjegjësimin e votuesve, arsyet për mbështetjen e një kandidati apo partie, sjelljet kundrejt pjesëmarrjes së grave në votime dhe atyre që konkurojnë, të kuptuarit e dhunimit të votës dhe sanksioneve që lidhen me të, dhe ndikimin e Reformës së re Administrative Territoriale në sjelljen e votuesve. Diskutimet eksploruan gjithashtu edhe faktorët motivues të votimit, dhe çfarë idesh apo mesazhesh nxisin më tepër qytetarët për të marrë pjesë në votime.

## II. METODOLOGJIA

UNDP kontrakttoi Partnerët Shqipëri për të organizuar një seri prej tetë grupesh të fokusuara duke kombinuar vendndodhjet në zona rurale dhe urbane në Shqipërinë e Veriut, të Mesme dhe atë Jugore. Në veçanti, UNDP i kërkoi Partnerëve Shqipëri të fokusohet në zonat që mund të jenë më të prekura (në terma zgjedhjesh dhe sjellje të votuesve) nga Reforma Administrative Territoriale. Ato përfshinin komuna dhe bashki të cilat po bashkohen me të tjera duke "humbur" statusin e tyre aktual si dhe Kryetarët dhe Këshillat e zgjedhur vendorë, si edhe ato që po bëhen qendra e një bashkie të re duke "përfshirë" fshatra dhe qytete të tjera.

Në bashkëpunim me UNDP, Partnerët Shqipëri përgatiti një plan për të gjitha aktivitetet, duke përfshirë lokalitetet, datat, vendet e takimeve, si dhe kohëzgjatjen dhe formatin e diskutimit. Stafi kyç i Partnerëve Shqipëri hartoi një Guidë Diskutimi në konsultim të ngushtë me Menaxherin e Projektit dhe Krye Këshilltarin Teknik të UNDP. Pjesëmarrësit u zgjodhën përmes databazës së kontakteve që Partnerët Shqipëri ka zhvilluar si pjesë e punës së saj të vazhdueshme me organizata të ndryshme të shoqërisë civile, qeverisë, shoqatave të biznesit dhe ato profesionale, institucioneve akademike dhe rrjeteve të gazetarëve në lokalitetet e përzgjedhura. Pjesëmarrësit ishin të gjithë banorë të qendrës së bashkive dhe komunave ku u organizuan grupet e fokusuara, dhe nga fshatrat përreth tyre. Gupet e fokusuara kishin pjesëmarrës me etni, nivel arsimor, ekonomik e kulturor të ndryshëm, me moshë nga 17 deri 72 vjeç, dhe një numër përafërsisht të njëjtë burra dhe gra. Një rëndësi e veçantë iu kushtua qytetarëve që kanë kanë më pak akses në informacion apo eksperiencë mbi zgjedhjet apo çështjet

---

<sup>1</sup>Më parë Shqipëria ka qënë organizuar në 373 njësi të qeverisjes vendore, që konsistojnë në 64 Bashki (përgjithësisht vendbanime urbane) dhe 309 komuna (vendbanime të përbëra kryesisht nga disa fshatra ose qytete të vogla). Tirana, kryeqyteti, ishte e ndarë në 11 njësi bashkiake, secila prej të cilave kishte Kryetarin dhe Këshillin e vet.

<sup>2</sup>Grupet e Fokusuara u organizuan në datat 3-10 prill në Vorë, Rubik, Orikum, Urë Vajguore, Ndroq, Mbrostar, Dropull dhe Bushat.

publike, si të rinjtë, minoritetet etnike, të papunët apo të punësuarit me kohë të pjesshme, emigrantët e kthyer rishtazi, shtëpiaket dhe pensionistët.

Vendet e organizimit të grupeve të fokusuar ishin hapësira në pronësi private në lokalitetet përkatëse, në mënyrë që pjesëmarrësit të ndiheshin rehat dhe të relaksuar gjatë diskutimit dhe pa asnjë formë ndikimi nga përfaqësuesit e qeverisjes vendore. Çdo grup i fokusuar zgjati rreth 2 orë.

Një moderator nga Partnerët Shqipëri lehtësoi diskutimin, duke i drejtuar pyetje pjesëmarrësve, bazuar në Guidën e Diskutimit dhe kohës në dispozicion. U bënë përpjekje për të siguruar që çdo pjesëmarrës të kishte mundësi të barabarta për të folur për secilën çështje. Një person tjetër mbajti shënime dhe regjistroi deklaratat, opinionet dhe të kuptuarit e pjesëmarrësve, si dhe u bë një regjistrim zanor i diskutimit me aprovimin e pjesëmarrësve. Partnerët Shqipëri kishte edhe një vëzhgues i cili monitoronte grupet e fokusuar për të mbajtur shënim mbi sjelljet dhe komunikimin joverbal të pjesëmarrësve. Stafi i UNDP gjithashtu vëzhgoi diskutimet në grup të fokusuar të përzgjedhur.

### **III. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE**

#### **a. Ndërgjegjësimi mbi çështjet kryesore zgjedhore dhe qytetare**

- Kishte një ndërgjegjësim thuajse të përgjithshëm mbi çështjet bazike: ka zgjedhje në 21 Qershor për qeverisjen vendore, votohet për Këshillin dhe Kryetarin/en e Bashkisë dhe ka një riorganizim territorial të bashkive.
- Kishte pak informacion si për kandidatët/et për Kryetar Bashkie ashtu edhe për ata/ato të Këshillit. Kjo ishte disi e pritshme duke marrë në konsideratë stadin e hershëm të kalendarit zgjedhor, por procesi i zgjatur për të vendosur për një kandidat për Kryetar Bashkie duket të ketë patur ndikim në ndërgjegjësimin e votuesve në këtë fazë të zgjedhjeve krahasuar me vitet e mëparshme.
- Pjesëmarrësit dyshonin se mund të mësonin ndonjëherë se cilët ishin kandidatët/et për Këshillat Bashkiakë; ata u shprehën që qytetarët rrallë e kishin këtë informacion para Ditës së Votimit.
- Nuk kishte pothuajse fare njohuri mbi tematika më të avanzuara zgjedhore apo qytetare lidhur me Këshillat Bashkiakë, si për shembull si do të zgjidhet Këshilli, numri i të zgjedhurve në Këshill, kohëzgjatja e mandatit të Këshillit, etj.
- Nuk kishte shqetësime për sa i përket listës së votuesve; pjesëmarrësit dukej se ishin shumë të familjarizuar me procesin e verifikimit përpara Ditës së Zgjedhjeve.
- Pjesëmarrësit treguan një nivel të lartë ndërgjegjësi lidhur me fshehtësinë e votës dhe rastet kur votuesit mund të ndihmojnë të tjerë për të hedhur votën, dhe se çfarë konsiderohet asistencë e papërshtatshme gjatë votimit.
- Ndërkohë që pjesëmarrësit tregonin se praktika e votimit familjar, ku kryefamiljari hedh votën për të gjithë anëtarët e familjes, është një “praktikë e së shkuarës” në Shqipëri, kishte njëfarë

pranimi të praktikës që kryefamiljari vendos për të gjithë anëtarët e familjes se si duhet të votojnë.

- Kishte shumë pak ndërgjegjësime për sa i përket ndëshkimeve për vjedhjen e votës apo ndonjë rast të zbatimit të këtyre ndëshkimeve në zgjedhjet e mëparshme.

### **b. Motivimi për të votuar dhe për të mbështetur kandidatët apo partitë**

- Pjesëmarrësit shprehën një apati të konsiderueshme dhe dyshonin nëse vota e tyre do të “sillte ndryshim”; kishte gjithashtu mungesë të konsiderueshme besimi në procesin zgjedhor.
- Pjesëmarrësit ndjenin se procesi i zgjedhjeve duhet të jenë më transparent dhe rezultatet duhet të shpallen më shpejt. Mungesa e kushteve të tilla ka ulur entuziazmin për të votuar.
- Pavarësisht këtyre përshtypjeve negative, ndjesia e përgjithshme e pjesëmarrësve ishte se do të shkonin për të votuar, ndërsa disa përgjigjedhënës u shprehën se nuk do të votonin nëse nuk do t’u pëlqenin kandidatët e partive.
- Arsyet më bindëse se përse qytetarët duhej të votonin, lidheshin me përmbushjen e detyrës qytetare apo përgjegjshmërisë si qytetar. Bindëse, por jo kudo, ishte edhe arsyeja se votimi të jep mundësinë të ndikosh në ndryshimin e komunitetit ku jeton.
- Të rinjtë dhe ata që votonin për herë të parë treguan më tepër entuziazëm për të votuar dhe besim në rëndësinë e të votuarit.
- Shumica e pjesëmarrësve thanë se bindjet politike ishin më pak të rëndësishme për ta sesa kanë qënë në të shkuarën. Nivelet e larta të zhgënjimit nga partitë, kanë ndikuar në dëshirën për të zgjedhur më tepër kandidatë me reputacion, moral, arritje, jetë të rregullt familjare e cilësi të tjera personale, më tepër sesa bazuar vetëm në përkatësinë partiake.
- Përpos cilësive të kandidatëve, platforma e propozuar dhe ide të tjera që ai apo ajo mund të ketë, përbën arsyen e dytë më të cituar për mbështetjen e kandidatit/es.
- Të rinjtë shprehën më tepër interes për politikën sociale të kandidatëve, si edukimi, kultura, asistencë për personat me aftësi të kufizuara, etj.
- Shumica e pjesëmarrësve shprehën motivim më madh për të votuar për një kandidatë grua përkundrejt një burri, pasi konsiderojnë se një grua do të ishte më e kujdesshme në çështjet ekonomike, më e devotshme në punë, e përgjegjshme nga natyra dhe më pak e korruptueshme.

### **c. Ndikimet në motivimin dhe sjelljen e votuesve lidhur me Reformën Administrative Territoriale**

- Opinione të pjesëmarrësve varionin në faktin nëse tani vota e tyre do të jetë më tepër apo më pak e rëndësishme për shkak të riorganizimit të territorit dhe se sa ndikon kjo në gjasat për të votuar. Kishte një korrelacion pozitiv midis pakënaqësisë së përgjithshme mbi reformën dhe

paqartësisë mbi mënyrën se si ajo do të funksionojë për komunitetin përkatës, dhe gjasave më të pakta për të votuar Ditën e Zgjedhjeve.

- Shumica e pjesëmarrësve nga komunitetet më të vogla shprehën një motivim më të ulët për të votuar sepse nuk do të kenë mundësi të marrin (të paktën jo lehtësisht) shërbimet bazë nga të zgjedhurit e tyre vendorë. Një ndjenjë e përgjithshme ishte se këto komunitete do të “humbasin” në një njësi më të madhe dhe do të neglizhohen.
- Ata në qytete më të mëdha - në qendër të bashkive të reja - thanë gjithashtu se ndiheshin më pak të prirur të votojnë sepse tashmë burimet e tyre do të shpërndahen në mënyrë jo të drejtë me komunat më të vogla dhe se territori i zgjeruar do të ketë një ndikim negativ në ofrimin e zgjidhjeve të problemeve për banorët.
- Pjesëmarrësit theksuan si faktor demotivues edhe mungesën e përfaqësimit të komunitetit në qeverisjen e re vendore.
- Disa pjesëmarrës ndiheshin më të prirur për të votuar, sepse tani ekzistojnë mundësi reale për përmirësime në komunitet, si rrjedhojë e faktit që ata do të jenë pjesë e një njësie më të madhe me më tepër fonde. Këta pjesëmarrës mendonin gjithashtu se Kryetari i Bashkisë do të ishte më serioz dhe i përgjegjshëm, administrata do të ishte më pak e kushtueshme dhe do të kishte më pak korrupsion në nivel vendor.
- Kishte nevojë të konsiderueshme për informacion se si do të funksionojnë njësitë e reja administrative (brenda Bashkisë së re) dhe se si do të krijohen ato.

## IV. GJETJET DHE ANALIZA E PLOTË

### a. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i përgjithshëm i votuesve

Ka disa lloje ose klasifikime të edukimit të votuesve: mbi procedurat e votimit dhe informacionit të rëndësishëm mbi të drejtën e votimit; mbi zgjedhjet e mundshme të kandidatëve dhe platformave të tyre, në dispozicion të qytetarëve; mbi rritjen e edukimit dhe motivimit të elektoratit; dhe çështje të tjera. UNDP e vuri theksin në tematikat që kanë qënë tradicionalisht subjekt i programeve të edukimit të votuesve në Shqipëri. Në fakt, shumë nga këto tematika janë pjesë e Planit të aprovuar të KQZ për Edukimin e Votuesve për këto zgjedhje.<sup>3</sup>

- **Zgjedhjet/Alternativat politike**

Nga diskutimet rezultoi një nivel i qëndrueshëm i të kuptuarit dhe ndërgjegjësimit bazë të votuesve në Shqipëri: pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në grupet e fokusuara ishin të informuar mbi llojin, qëllimin dhe datën e zgjedhjeve që do të zhvillohen në qershor. Pjesëmarrësit, në mënyrë të njëtrajtshme, e dinin që do të votonin për zgjedhjen e Kryetarit/es dhe anëtarëve/eve të Këshillit Bashkiak, edhe pse pak prej tyre (më pak se 5%) thanë se nuk e dinin për ndryshimet në organizimin territorial vendor dhe se nuk do të votonin më për Kryetarin/en e Komunës së tyre (Mbrostar dhe Dropull). Disa pjesëmarrës gjithashtu kërkuan informacion se kush i zgjedh kandidatët/et për Kryetar/e dhe cila është përqindja e

<sup>3</sup> E disponueshme në <http://www2.cec.org.al/sq-al/>

nevojshme për të qënë Kryetar/e Bashkie. Lidhur me zgjedhjet/alternativat politike në dispozicion të elektoratit, situata ishte shumë e paqartë. Pjesëmarrësit, në kohën kur grupet e fokusuara u organizuan, thanë se njerëzit kanë pak ose aspak informacion mbi kandidatët/et përkatës/e për Kryetar/e Bashkie. Qarkullonin zëra në zona të ndryshme për emrat e kandidatëve/eve (për shembull në Vorë, Urë Vajgurore dhe Rubik). Vetëm në një zonë, në Bushat, pjesëmarrësit ndiheshin të sigurt për përzgjedhjen e kandidatit nga ana e koalicionit të majtë. Në kohën e organizimit të grupeve të fokusuara, kandidatët nuk ishin regjistruar, apo për pjesën më të madhe as nuk ishin shpallur zyrtarisht, kështu që kjo nuk është domosdoshmërisht një çështje që përbën shqetësim.<sup>4</sup> Megjithatë, mund të thuhet se pasiguria e shtuar për përzgjedhjen e një kandidati për të përfaqësuar disa “ish-njësi të qeverisjes vendore” dhe negociatat e zgjatura mbi përzgjedhjen e kandidatit të partisë, duket se kanë kontribuar në pasigurinë e votuesve për kandidatët në këtë fazë të procesit zgjedhor krahasuar me vitet e mëparshme.

Lidhur me kandidatët/et për Këshillat Bashkiakë, situata ishte shumë më e keqe. Pjesëmarrësit nuk kishin aspak informacion, as zyrtar as të ndonjë lloji tjetër. Shumë pjesëmarrës, bazuar në eksperiencën e zgjedhjeve të mëparshme, shprehën bindjen se nuk do ta kishin këtë informacion përpara zgjedhjeve. Pjesëmarrësit përmendën se qytetarët do të donin të njihnin kandidatët/et përpara Ditës së Zgjedhjeve, në mënyrë që të bëjnë vlerësimin e tyre bazuar në eksperiencën, kontributin në shoqëri dhe komunitet, dhe në programet e propozuara.

- **Listat e votuesve**

Saktësia e listave të votuesve ka qënë historikisht problem në Shqipëri dhe iniciativa të konsiderueshme janë ndërmarrë për të përmirësuar si listat e votuesve ashtu edhe ndërgjegjësimin për të drejtën dhe përgjegjësinë qytetare për të verifikuar saktësinë e informacionit të së drejtës për të votuar në periudhën përpara zgjedhjeve. Kjo është një nga tematikat që KQZ do të adresojë në fushatën e ndërgjegjësimit të 2015.

Pjesëmarrësit në grupet e fokusuara nuk shprehën praktikisht asnjë shqetësim lidhur me përfshirjen e tyre apo të familjarëve të tyre në listat e votuesve. Pjesëmarrësit ndjenin se qytetarët janë të ndërgjegjshëm se duhet të kontrollojnë emrat e tyre në listat e votuesve dhe se këto lista janë të publikuara në hapësira publike, të njohura mirë nga qytetarët. Pjesëmarrësit listuan godinën e bashkisë apo komunës, qendrat shëndetësore, shkollat, baret, ndërtesat publike dhe qendrat e votimit si vendet ku listat afishohen zakonisht. Në disa vende (Mbrotar, Dropull, Ura Vajgurore, Rubik, dhe Orikum) pjesëmarrësit në grupet e fokusuara konfirmuan se listat e votuesve ishin publikuar dhe se i kishin kontrolluar dhe verifikuar personalisht emrat e tyre dhe të familjarëve të tyre. Pjesëmarrës të tjerë raportuan gjithashtu se në lokalitetin e tyre ishte bërë edhe një verifikim i listave të votuesve. Ata thanë se ose kishin marrë një letër në shtëpi me emrat e familjarëve për të kontrolluar nëse ishin përfshirë të gjithë në listën e votimit dhe për të raportuar ndonjë mungesë të mundshme, ose janë vizituar në shtëpi nga përfaqësues të bashkisë për të kontrolluar emrat e tyre në listat e votuesve dhe për t'i orientuar ata në qendrat e votimit.

Thuajse në të gjitha grupet e fokusuara, të rinjtë dhe ata që votonin për herë të parë kishin më pak njohuri mbi publikimin dhe kontrollin e listave të votuesve dhe, siç deklaruan disa prej tyre, është një anëtar i familjes, zakonisht kryefamiljari, që kontrollon emrat për të gjithë familjen. Idea e një anëtari që

---

<sup>4</sup> Në shoqëritë pluraliste dhe të lira, partitë që konkurojnë sigurohen që publiku të jetë i mirë informuar mbi zgjedhje të tilla dhe se ka gjasa që të ketë rritje të konsiderueshme të informacionit për sa i përket kandidatëve/eve dhe partive në Shqipëri në javët në vazhdim.



kontrollon për të gjithë familjen u përsërit në disa grupe të fokusuar. Një pjesëmarrës (Bushat) tha se nuk kishte kohë të mjaftueshme për të verifikuar informacionin e votuesve.

- **Fshehtësia e votës**

Garancia e fshehtësisë së votës është një kusht i rëndësishëm dhe i nevojshëm në çdo zgjedhje demokratike. Aspekti i fshehtësisë së votimit do të theksohet në shumicën e spoteve që KQZ do të nxjerrë në television dhe radio sipas Planit të Edukimit të Votuesve të KQZsë - në mesazhe për procedurat e votimit, në mesazhe që targetojnë persona me aftësi të kufizuara dhe në mesazhe të hartuar specifikisht për votueset gra. Këto spote fokusohen kryesisht në aktin e hedhjes së fletës së votimit, me përjashtimin e spotit të hartuar për votueset gra që mbulon edhe çështje të tjera sistemike lidhur me fshehtësinë e votës dhe votimin familjar.

Të gjithë pjesëmarrësit në grupet e fokusuar ishin të ndërgjegjshëm se vota është e fshehtë dhe personale; askush tjetër nuk mund të votojë për ty dhe as ata (pjesëmarrësit) nuk mund të votojnë për dikë tjetër. Pavarësisht kësaj, disa diskutime u fokusuan në faktin që ato janë lokalitete të vogla dhe njerëzit zakonisht flasin hapur me njëri-tjetrin për bindjet e tyre politike, kështu që dihet se për cilin/cilën kandidat/e kanë votuar. Pjesëmarrësit në një masë të madhe binin dakort se një anëtar i familjes mund të hedhë fletën e votimit për një tjetër votues i cili ka nevojë për asistencë, por pa influencuar në votë, si në rastet e njerëzve të verbër apo të moshuar.<sup>5</sup>

Lidhur me votimin familjar, shumica e pjesëmarrësve mendonin se kjo gjë i përket të shkuarës tashmë dhe nuk kishte raste, të paktën në dijeni të tyre, që kjo gjë të kishte ndodhur.<sup>6</sup> Sipas disa pjesëmarrësve, kjo gjë mund të ndodhë në zona rurale të thella; megjithatë, ata nuk kishin të dhëna reale për ndodhi të tilla. Në të njëjtën kohë, shumica e pjesëmarrësve ishin dakort me mendimin se ka ndikim mes anëtarëve të një familje lidhur me faktin se për kë të votojnë. Skenari më i shpeshtë ishte që kryefamiljari mund të mos hedhë votën për anëtarët e tjerë të familjes, por ai dikton se si duhet të votojë gjithësecili në familje.

Të rinjtë dhe ata që votojnë për herë të parë kishin shumë dëshirë dhe ishin të vendosur për të votuar vetë, pasi e shikonin votën si një të drejtë personale për të shprehur opinionin e tyre pa ndërhyrje apo ndikime. Një pjesëmarrës bëri një lidhje interesante midis uljes së votimit familjar me rritjen e apatisë së votuesve, dhe me rritjen e përgjegjësisë së komisionerëve të votimit në lidhje me fshehtësinë e votës.

- **Sanksionet**

Pjesëmarrësit në një masë të madhe pranuan se ka raste të vjedhjes/shitblerjes së votës në format e presioneve/kërcënimeve fizike apo psikologjike, presione/kërcënime nga punëdhënësit dhe këmbimi i votës me para apo të mira materiale. Megjithatë, thujse të gjithë pjesëmarrësit (95% e tyre) nuk ishin në dijeni të ndonjë personi të ndëshkuar për këto veprime. Vetëm disa pjesëmarrës ishin në gjendje të përmendnin masat ndëshkuese, që varionin nga gjobitje në burgosje.

Të pyetur mbi masat apo faktorët që do të ndalonin një fenomen të tillë, pjesëmarrësit mendonin në një masë të madhe se kjo është një përgjegjësi e shtetit përmes miratimit dhe zbatimit të legjislacionit mbi vjedhjes/shitblerjes së votës, si dhe përmes organizimit të procesit të votimit. Shembujt më të zakonshëm të llojeve të veprimeve të tilla ishin (sipas popullaritetit): zëvendësimi i komisionerëve të

---

<sup>5</sup> Aktualisht Kodi Zgjedhor lejon asistimin për votuesit që nuk janë të aftë të votojnë në mënyrë të pavarur për arsye fizike nga familjarë ose nga një votues tjetër në listën e votimit të asaj njësie të votimit (Neni 108).

<sup>6</sup> Votimi familjar siç përcaktohet këtu i referohet hedhjes fizike të votës për një anëtar tjetër të familjes.

partive politike nga komisionerë profesionalë dhe jopartikë; zbatim më i mirë i ligjeve; rritje e ndërgjegjësimit dhe edukimit të qytetarëve mbi vjedhjen/shitblerjen e votës; përmirësimi i kushteve social-ekonomike (për të ulur joshjen nga shitja e votës); dhe ndëshkimi i kandidatëve që blejnë votën.

Pjesëmarrësit theksuan një nevojë të përgjithshme për më tepër informacion mbi këtë çështje. Një pjesëmarrës (në Rubik) shprehu një fakt interesant që ndërkohë që në qendrat e votimit ka shenja mbi veprime të ndaluara sic janë mbajtja e armëve apo pirja e duhanit, nuk ka shenja mbi vjedhjen/shitblerjen e votës.

## **b. Motivimi për votim dhe mbështetjen e një kandidati apo partie**

Njerëz të ndryshëm motivohen nga arsye të ndryshme për të marrë pjesë në zgjedhje – nga ndjenja e ushtrimit të detyrës qytetare, për mbështetjen e një kandidati apo kauze të caktuar, nga frika e humbjes së të drejtës për të vendosur për çështjet e komunitetit. Duke qënë se motivimi do të jetë një pjesë e rëndësishme e informimit dhe programeve edukative të KQZsë dhe aktorëve të ndryshëm të interesit, UNDP donte të mësonte rreth asaj se çfarë i shtyn votuesit për të marrë pjesë në zgjedhje në Shqipëri, dhe në veçanti në zgjedhjet vendore. Duke qënë se zgjedhjet vendore sjellin kandidatë/e që janë shumë pranë elektoratit, kishte një interes për të kuptuar se çfarë e bën një votues të mbështesë një kandidat/e të caktuar.

- **Arsyet për të votuar**

Kur u pyetën nëse duke votuar, mund të sillnin një ndryshim në komunitet, pjesëmarrësit ishin përgjithësisht pesimistë. Pjesëmarrësit shprehën zhgënjim mbi drejtuesit e zgjedhur vendorë të mëparshëm dhe aktualë, dhe nuk ishin të bindur se vota e tyre do të sjellë ndonjë ndryshim në gjendjen ekzistuese të katër viteve të fundit. Vetëm disa pjesëmarrës (në një grup të fokusuar në Dropull) shprehën të paktën shpresën se kjo gjëndje do të ndryshojë mbas këtyre zgjedhjeve. Thënë sa më sipër, kur pjesëmarrësit u pyetën se cilat ishin arsyet e rëndësishme për të votuar, rreth gjysma deklaroi për të pasur një të ardhme më të mirë, apo për të sjell ndryshime. Arsyet tjera që u dhanë në mënyrë frekvente përfshijnë: për të zgjedhur kandidatin që do ti përfaqësojë ata; për të kryer detyrën e tyre qytetare; për të marrë një vendim për veten e tyre; për të mos dhënë mundësi për manipulimin e votës; dhe për të patur shërbimet e bashkisë.

Pjesëmarrësit mendonin që aryeja kryesore se pse njerëzit nuk votonin përfshinte pakënaqësinë në lidhje me drejtuesit e zgjedhur dhe mungesën e besimit të kandidatët, dhe se vota e tyre nuk kishte rëndësi. Ekziston një zhgënjim i konsiderueshëm në mosmbajtjen e premtimeve nga drejtuesit e zgjedhur të mëparshëm, dhe pak ndryshim apo përmirësim në jetët e tyre si rezultat i proceseve politike. Pjesëmarrësit në Orikum dhe Ura Vajgurore ishin më pesimistët, duke thënë se pjesa më e madhe e qytetarëve janë të ngopur me premtime të pambajtura dhe me mungesën e investimeve, dhe kanë humbur besimin në institucionet publike dhe administratën vendore. Vetëm në Dropull pjesëmarrësit menduan se nuk ka një arsye të rëndësishme që ndikon në pjesëmarrjen e votuesve, dhe se në fakt pjesa më e madhe e qytetarëve në moshë për të votuar do të votojnë në zgjedhjet e ardhshme.

Të rinjtë që votojnë për herë të parë qartësisht shprehën një motivim dhe interes më të madh në krahasim me grupet e tjera demografike.

Pjesëmarrësve iu prezantuan një seri më deklarata apo stimuj dhe u pyetën se si secila prej tyre përshkruante motivimin e tyre për të votuar. Përgjigjet ishin gjerësisht të përzjera si midis grupeve të fokusuar në të gjithë vendin ashtu edhe mes pjesëmarrësve në një grup të fokusuar.

Deklarata ***pjesëmarrja në votim ju jep mundësi të ndikoni në vendimet që merren për komunitetin tuaj*** shpesh u konsiderua e rëndësishme, por pjesëmarrësit u shprehën se nuk ka patur evidenca që kjo të ndodhë me të vërtetë dhe ndaj dyshuan në rëndësinë e saj. Më shumë se një diskutim vuri në dukje se pasi zgjidhej, zyrtari i zgjedhur nuk do të shihej më nga votuesit deri në zgjedhjet e ardhshme. Megjithatë, kjo deklaratë ishte më bindësja (nga ato të dhëna) për pjesëmarrësit në Rubik dhe në Vorë. Në Mbrostar dhe në Ndroq, në të kundërt, qytetarët nuk ranë aspak dakort me këtë deklaratë. ***Pjesëmarrja në votim është detyra juaj qytetare dhe duhet marrë seriozisht*** ishte deklarata me bindëse nga të gjitha. Idea që ***rezultatet në zgjedhjet e mëparshme vendore janë vendosur vetëm me pak vota*** nuk ishte shumë bindëse. Vetëm në një lokalitet ky koncept kishte pak besueshmëri (Vora). Në disa lokalitete (Bushat dhe Mbrostar) nuk e konsideruan të përshtatshme pasi Kryetarët ishin zgjedhur nga një shumicë e gjerë. Kur pjesëmarrësit u pyetën nëse fakti që ju do të jeni në gjendje ***të shihni se si fshati apo komuniteti juaj votoi për Kryetarin/en dhe Këshillin duke i parë rezultatet në TV apo në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së natën e votimit*** është një incentivë pozitive për të votuar, ata gjerësisht ranë dakort se nëse kjo ndodh do të ishte shumë mirë, por deri më tani është dashur shumë kohë për të shpallur kandidatin/en fitues/e. Sipas opinionit të tyre, kjo vonesë shkakton tek njerëzit humbje besimi në rezultatet dhe transparencën e procesit, duke nxitur apati ndaj pjesëmarrjes në votim.

Kishte disa efekte në motivimin e votuesit që rezultojnë nga Reforma Administrative Territoriale. Sikurse këta janë faktorë të rinj që ndoshta do të kenë një ndikim për herë të parë në sjelljen dhe zgjedhjen e votuesve, janë përshkruar në seksionin në vijim.

- ***Preferencat për kandidatin/en***

Pjesëmarrësit në grupet e fokusuar pranuan se në zgjedhjet e mëparshme ata kanë qënë të ndikuar kryesisht nga përkatësia politike e kandidatëve/eve në vendimin se për kë do të votojnë. Megjithatë, ata deklaruan se për shkak të zhgënjimeve të përgjithshme me Kryetarët e zgjedhur të bashkive dhe komunave dhe anëtarët e Këshillit, ata do të ndikohen më tepër nga integriteti dhe cilësitë e kandidatit/es dhe çfarë ai apo ajo prezanton, pavarësisht forcës politike që ai apo ajo përfaqëson. Shumica e pjesëmarrësve në të gjitha grupet e fokusuar deklaruan se do të zgjidhin për të votuar një kandidat/e bazuar në cilësitë personale, të tilla si reputacioni, morali, eksperiencia, jeta familjare dhe fomimi profesional, dhe arsimit. Në vend të dytë përse i përket rëndësisë vinte programi dhe platforma e kandidatit (partisë) dhe ndryshimet e propozuara që ai apo ajo do të sjellë për komunitetin. Kjo mund të jetë për shkak të mendimit të shprehur gjerësisht se kandidatët bëjnë shumë premtime gjatë fushatës të cilat nuk i mbajnë pasi zgjidhen. Kjo gjithashtu mund të shpjegojë pse të rinjtë që votojnë për herë të parë (të cilët duhet të jenë më pak të zhgënjyer nga zgjedhjet e mëparshme) ishin më të prirur të përmendnin këto arsye në krahasim me pjesëmarrësit e tjerë. Pjesëmarrësit e rinj ishin gjithashtu të interesuar në pozicionet dhe propozimet e kandidatit/es mbi arsimin, rininë dhe kulturën. Ndërkohë që pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ranë dakort me një nga deklaratat e listuara më sipër, shumë pak prej

tyre deklaruan se kandidatin/en do ta votonin bazuar në përkatësinë e tij / saj politike, apo bazuar në një balancë mes përkatësisë politike dhe besimit në individ.

Në lidhje me çfarë ata dëshironin të shikonin në platformat e kandidatit/es apo partisë, pjesëmarrësit përmendën disa çështje të cilat lidhen kryesisht me probleme të përditshme dhe specifike me të cilat qytetarët ndeshen në lokalitetet e tyre. Të gjitha grupet e fokusuar u përqëndruan rreth dy fushave kryesore: mundësi punësimi dhe krijimi i vendeve të reja të punës; dhe infrastruktura, që përfshin rrugët, kanalizimet, elektricitetin dhe furnizimin me ujë të pijshëm. Të përmendura nga një numër pjesëmarrësish ishin edhe çështjet e ofrimit dhe shërbimet e kujdesit shëndetsore, çështjet e lidhura me sigurinë (parandalimin e krimit, etj.), dhe hapsirat e gjelbërta dhe parqet (vende për fëmijët dhe familjet).

Kur u pyetën nëse kishte rëndësi nëse një kandidat është burrë apo grua, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve deklaruan se ky nuk është një faktor i rëndësishëm në zgjedhjet politike. Më e rëndësishme për qytetarët është integriteti, personaliteti, aftësitë dhe profesionalizmi i kandidatit/es. Më tej, u shfaqën argumenta favorizues si për kandidatët burra ashtu edhe për kandidatet gra. Shumë pjesëmarrës thanë se qytetarët do të ndiheshin më të motivuar për të votuar për një kandidat grua, pasi vlerësojnë që një grua është më pak e korruptueshme, më e kujdesshme me menaxhimin e ekonomisë, më e motivuar për të punuar, e ndjeshme ndaj nevojave të qytetarëve, kupton më mirë nevojat e komunitetit, dhe është më e përgjegjshme nga natyra. Pjesëmarrësit deklaruan se do të ndiheshin mirë dhe më të përfaqësuar nga një drejtuese politike grua. Një numër shumë i vogël pjesëmarrësish, në të kundërt, shprehën bindjen se Kryetari duhet të jetë një burrë sepse ai ka më tepër energji për punë, është përgjithësisht një figurë më e fuqishme, dhe mund të marrë vendime më lehtë.

### **c. Influenca në sjelljen e votuesve që rezultojnë nga Reforma Administrative Territoriale**

Rreth një vit e gjysëm më parë, qeveria shqiptare nisi një program reforme për të konsoliduar 373 bashkitë dhe komunat ekzistuese në 61 bashki të reja. Sikurse procesi ka ndodhur kohët e fundit, dhe qytetarët do të votojnë në zona elektorale tërësisht të reja gjeografikisht, ka disa pyetje në lidhje me ndikimin e kësaj reforme në sjelljen e votuesve.

#### **• Ndërgjegjësimi mbi Reformën Administrative Territoriale**

Siç është përmendur më sipër, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin në dijeni se ka ndodhur një reformë për organizimin dhe administrimin territorial të vendit. Megjithëse jashtë fokusit të kërkimit, ishte e pamundur të izoloheshin nga diskutimet pyetjet e shumta dhe shqetësimet rreth procesit dhe ndikimit të Reformës Administrative Territoriale në jetën e përditshme të pjesëmarrësve.

Pjesëmarrësit mendonin se qytetarët kishin nevojë për më tepër informacion lidhur me kufijtë e bashkisë së re, të gjithë fshatrat dhe qytetet brenda bashkisë së re, numrin e qytetarëve, funksionet e bashkisë dhe njësisë administrative brenda bashkisë së madhe, dhe shërbimet që do të ofrohen për qytetarët. Pjesëmarrësit dëshironin të dinin se si do të shkojnë ekzaktësisht shërbimet tek qytetarët, nëse do të ketë ndonjë zyrë qeverisëse në lokalitetin e tyre, dhe nëse po, si do të funksionojë dhe çfarë shërbimesh do të ofrojë. Pjesëmarrësit nuk ishin të qartë se çfarë do të ndodhte me qeverisjen apo

administratën e komunës së tyre aktuale (psh., kush do di drejtojë njësitë administrative brenda bashkisë së re) dhe se si është vendosur ky proces. Për shembull, pjesëmarrësit ishin në dijeni që do të votonin për një Kryetar/e që do të qeverisë disa bashki dhe komuna aktuale, por dëshironin të dinin nëse do të ketë një përfaqësues të kryetarit/es të/së ri/re apo ndonjë strukturë tjetër administrative për të zëvendësuar funksionet qeverisëse që aktualisht kanë në nivel komune. Ata gjithashtu shprehën një shqetësim se do të jetë e vështirë të tërheqësh vëmendjen e Kryetarit/es të/së ri/re (dhe në këtë mënyrë të zgjidhësh problemet), meqënëse njësia e qeverisjes vendore do të jetë në një masë të konsiderueshme më e madhe se më parë. Këto shqetësime janë ngritur kryesisht nga pjesëmarrësit në lokalitete të cilat do të bashkohen me të tjera, ku qendra e bashkisë së re do të ishte diku tjetër.

Disa pjesëmarrës shprehën shqetësimin e tyre në lidhje me procesin e Reformës Administrative Territoriale. Ata mendonin se qytetarët nuk u pyetën dhe nuk u konsultuan gjatë procesit apo në vendimet e marra.

- **Ndikimi në rëndësinë e votimit**

Krahasuar me zgjedhjet e mëparshme në Shqipëri, pjesëmarrësit u ndanë në mënyrë të barabartë në bazë të besimit të tyre se vota do të ishte më tepër apo më pak e rëndësishme në këto zgjedhje. Arsyet se përse vota ishte *më pak* e rëndësishme tani ishin gjerësisht të lidhura me ndryshimet në njësitë e qeverisjes vendore (dhe kryetarët e tyre vendorë dhe anëtarët e këshillit) që rrjedhin nga Reforma Administrative Territoriale. Megjithatë, kishte arsye të tjera të ndryshme që lidhen me apatinë e përgjithshme të votuesve dhe zhgënjimin me drejtuesit e zgjedhur. Nga ata pjesëmarrës që mendonin se ishte *më tepër* e rëndësishme tani për të votuar, arsyet ishin tërësisht të lidhura me Reformën aktuale Administrative Territoriale dhe ndryshimet që do të sjellë në administratën vendore dhe shpërndarjen e burimeve.

Arsyeja më e zakonshme e dhënë se pse votimi ishte *më pak* i rëndësishëm për pjesëmarrësit tani, kishte të bënte me përkatësinë në një bashki më të madhe dhe rrjedhimisht mundësi më të pakta për të përfituar nga shërbimet e saj. Pjesëmarrësit mendonin se duke qënë më larg nga kryetari/ja dhe qendra e bashkisë do ta bënte më të vështirë adresimin e nevojave dhe zgjidhjen e problemeve të tyre. Pjesëmarrësit nga komuna më të vogla që do të bashkohen tashmë një bashkie më të madhe mendonin se do të lihen mënjanë dhe pas dore; burimet do të investohen në qendrën e bashkisë dhe nuk do të shpërndahen në mënyrë të drejtë me të tjerët, në lokalitetet e vogla. Pjesëmarrësit nga komuna apo bashki më të mëdha trembeshin nga e kundërta: që burimet e tyre do të ndaheshin tashmë me njësi të tjera më të vogla që do të bëhen pjesë e bashkisë së tyre të re. Komuna të tilla të vogla kështu do të përfitonin pa kontribuar realisht në bashki.

Zvogëlimi i rëndësisë së votës për pjesëmarrësit tentonte gjithashtu të lidhej me pakënaqësinë që ata kanë me procesin dhe rezultatet e reformës. Disa pjesëmarrës mendonin se vota e tyre është më pak e rëndësishme thjesht për shkak të zhgënjimit me drejtuesit dhe administratën aktuale të qeverisjes vendore, e cila nuk ka adresuar problemet e komunitetit. Si pasojë, ata ndjejnë që asgjë nuk do të ndryshojë dhe vota është e pakuptimtë.

Pjesëmarrësit të cilët konsideruan se vota e tyre do të jetë më e rëndësishme arsyetuan se duke qënë një njësie bashkiake më e madhe do të ketë më tepër fonde për komuniteti dhe staf më të kualifikuar, i cili do të do të jetë në gjendje të adresojë dhe të ti përgjigjet më mirë nevojave dhe problemeve të komunitetit. Gjithashtu, u shprehën edhe bindja se kryetari/ja i ri/e re do të duhet të qeverisë me një ndjenjë më të madhe përgjegjshmërie dhe llogaridhënie kundrejt komunitetit (më të gjerë) i cili e ka zgjedhur atë. Këta pjesëmarrës gjithashtu besonin se administrata vendore do të jetë më pak e

kushtueshme për buxhetin e kombinuar të bashkisë së re, dhe si rezultat do të ketë më tepër fonde për infrastrukturën dhe investimet e tjera.

Disa pjesëmarrës deklaruan se vota e tyre do të jetë njësoj e rëndësishme si më parë, duke arsyetuar se opinioni i publikut, dhe në këtë mënyrë edhe vota, është shumë e rëndësishme. Të rinjtë të cilët votonin për herë të parë nuk kishin një pikë referimi me të cilën ta krahasonin rëndësinë e votës në këto zgjedhje. Megjithatë, siç u përmend më parë, ata përgjithësisht mendonin se vota është shumë e rëndësishme dhe kishin dëshirë të merrnin pjesë në zgjedhje.

- ***Ndikimet mbi motivimin për të votuar***

Pavarësisht se ishin të ndarë mbi *rëndësinë* e votës së tyre në zgjedhjet vendore, shumica e pjesëmarrësve ndiheshin më pak të *motivuar* për të votuar në këto zgjedhje. Vetëm në Mbrostar pjesëmarrësit ndjenin përgjithësisht motivim më të madh për të votuar, në Dropull dhe Urën Vajgurore pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ndjenin se ishte njësoj e rëndësishme. Arsyet më të mëdha – për ata që ishin më pak dhe më tepër të motivuar për të votuar – ishin shpesh herë të lidhura me reformën.

Arsyetimi se përse ndiheshin më pak apo më tepër të prirur për të votuar pasqyrojnë afërsisht arsyet mbi rëndësinë e votës. Ato përfshijnë mosdakortësinë me procesin e reformës dhe bashkimin me një komunë tjetër (më të madhe), dhe me frikën se pjesa më e madhe e investimeve do të shkojë për komunitetet më të mëdha brenda bashkisë së re. Gjithashtu, pjesëmarrësit ndiheshin më pak të motivuar për shkak të një frike të mos përfaqësimit në zyrën e re të kryetarit dhe anëtarëve të këshillit. Në një grup të fokusuar (Orikum) tre të katërtat e pjesëmarrësve ndiheshin më pak të motivuar për të votuar tani, por theksuan se do të shkonin të votonin gjithsesi sepse njësia aktuale e qeverisjes vendore ka bërë pak për të përmisuar situatën në qytet dhe kishin nevojë për ndryshim.

Rreth një e pesta e pjesëmarrësve thanë se ishin më të motivuar për të votuar se më parë. Ata e lidhin këtë me besimin se mund të sillnin disa ndryshime për komunitetin dhe se ndryshimet territoriale do të sjellin më tepër mundësi dhe burime (sidomos financiare) për kryetarin/en e ri/re të zgjedhur. Ata gjithashtu besonin se reforma mund të rriste përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik ndaj qytetarëve, pasi ata do të jenë përgjegjës për një numër më të madh njërëzish se më parë. Përsëri, të rinjtë që votojnë për herë të parë në të gjitha grupet e fokusuara ndiheshin më të motivuar për të votuar në krahasim me grupet e tjera.

- ***Ndikimet mbi identifikimin me kandidatët***

Siç është përmendur në krye të këtij raporti, ndërmjet gjithë grupeve ka patur konfuzion në lidhje me kandidatët/et për kryetar/e dhe këshill. Pjesëmarrësit përmendën vonesën në shpalljen e kandidatëve/eve për kryetar/e bashkie dhe platformat e tyre në këto zgjedhje si një faktor dekurajues. Pjesëmarrësit besonin që do të ndiheshin më pak të lidhur me kryetarin/en, pavarësisht se kush do të jenë kandidatët/et, duke e shoqëruar mungesën e lidhjes me faktin se territori i bashkisë do të zgjerohet. Në lidhje me anëtarët/et e këshillit bashkiak, pjesëmarrësit nuk kishin njohuri mbi kandidatët/et, siç përmendet më sipër. Një pjesë e madhe e pjesëmarrësve shprehën pikëpamjen se nëse do të kishin një mundësi për të zgjedhur anëtarët/et individual të Këshillit në mënyrë të drejtpërdrejtë individualisht (kundrejt listave të partive), ata do të ndiheshin më të lidhur dhe të përfaqësuar në bashkinë e re.

## V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### a. Ndërgjegjësimi mbi çështjet thelbësore të zgjedhjeve

Bazuar në përgjigjet e pjesëmarrësve për pyetjet dhe çështjet e ngritura në grupet e fokusuara, mund të nxjerrim disa konkluzione mbi sjelljen e elektoratit shqiptar dhe cilat mund të jenë disa nga mangësitë aktuale në informacion. Këto gjetje sugjerojnë fusha ku mund të fokusohen programet e edukimit qytetar dhe edukimit të votuesve gjatë fushatës zgjedhore 2015, si dhe në një periudhë më afatgjatë, p.sh., midis zgjedhjeve. Ndërkohë që modelet e përgjigjeve ishin mjaft konsistente gjatë këtij studimi, kërkime plotësuese duhet të ndërmerren për të forcuar nivelin e besimit të gjetjeve kur koha dhe burimet ta lejojnë.

### b. Edukimi i përgjithshëm qytetar dhe i votuesve

Ka një shkallë të lartë të ndërgjegjësitimit mbi zgjedhjet dhe politikat në Shqipëri. Njerëzit janë përgjithësisht të informuar mbi shumicën e iniciativave të qeverisë, të tilla si Reforma Administrative Territoriale. Megjithatë, duket se njohuri të tilla nuk shkojnë përtej “bazikes”, prandaj një edukim i avancuar qytetar dhe zgjedhor do të ishte i dobishëm. Përpjekjet për edukimin e votuesit duhet të fokusohen në shpjegimin se si janë zgjedhur kandidatët (veçanërisht për këshillat), dhe rolet e zyrtarëve të zgjedhur. Ekziston gjithashtu një nevojë për informacion mbi kandidatët në listat e partive për këshillat bashkiakë.

Janë disa fusha mbi edukimin e votuesve, në të cilat organizata të ndryshme janë fokusuar tepër në vitet e fundit. Disa nga këto fusha, të tilla si verifikimi i listave të votuesve apo fshehtësia e votës, ndërkohë që mbeten ende shumë të rëndësishme, duken se janë shumë mirë të kuptuara në Shqipëri. Organizatat të cilat kryejnë edukimin e votuesve, duhet të konsiderojnë këtë mundësi kur planifikojnë mesazhet e tyre mbi edukimin e votuesve dhe të alokojnë burime të kufizuara tek fushata të tilla.

Ndërsa praktika e votimit për anëtarët e tjerë të familjes supozohet në rënie në Shqipëri, ekziston ende një shkallë e caktuar e pranimi të praktikës që kryetari i familjes (zakonisht burrë) vendos se si duhet të votojë familja. Për të ndikuar në një mendim dhe sjellje të tillë nevojiten përqasje më afatgjata të edukimit qytetar; rregulloret e zgjedhjeve, sanksionet dhe iniciativat e edukimit të votuesve fatkeqësisht kanë ndikim të limituar në këtë sjellje.

Kishte një mungesë të dukshme të ndërgjegjësitimit mbi ndëshkimet për vjedhjen/shitblerjen e votës. Ata që kryejnë programe për edukimin e votuesit mund të marrin në konsideratë tërheqjen e vëmendjes ndaj sanksioneve ekzistuese për akte të tilla si votimi për dikë tjetër, fallcifikimi i dokumentave zgjedhorë, kërcënimi i një mbështetësi të një kandidati/eje apo votuesi, etj. Kërcënimi i dënimit apo përforcimi negativ mund të rezultojë një stimul efektiv edukues. Sigurisht, mesazhe të tilla duhet të mbështeten nga zbatimi i sanksioneve kur kryhen aktet e vjedhjes/shitblerjes së votës, në të kundërt ato do të kenë shumë më pak ndikim tek njerëzit.

### **c. Motivimi për të votuar**

Kishte një mungesë të konsiderueshme të motivimit për të votuar e raportuar në grupet e fokusuara; megjithatë, është e vështirë të thuhet se si dhe nëse kjo do të përkthehet në qëndrimin në shtëpi të votuesve gjatë Ditës së Votimit, apo nëse qytetarët megjithatë do të votojnë të udhëhequr nga ndjenja e detyrës qytetare.

Duke konsideruar që pjesa më e madhe e pjesëmarrësve shprehën një mungesë besimi në procesin zgjedhor në përgjithësi, mund të jetë e këshillueshme t'i kushtohet pak vëmendje edukimit parazgjedhor për vet procesin dhe institucionet (KQZ, Kolegji Zgjedhor). Për shembull, mund të jetë e dobishme t'i shpjegohet qytetarëve se çfarë ndodh pasi ata hedhin votën e tyre (se si numërohen votat), kur duhet të pritët rezultati, dhe si ndahen mandatet.

Dukej se mesazhet që ndikojnë më shumë te votuesit mund të jenë ato që apelojnë për një ndjenjë përgjegjësie qytetare apo për ndikimin në ndryshim në komunitet. Ndërkohë që votuesit e rinj të cilët votojnë për herë të parë kanë nevojë të dukshme për informacion mbi procesin e votimit, motivimi i tyre për të marrë pjesë në zgjedhje mund të mos jetë një çështje e rëndësishme. Gjithsesi, ka nevojë për më tepër kërkime mbi pjesëmarrjen e votuesve të rinj.

Ndërkohë që pjesa më e madhe e pjesëmarrësve deklaruan se përkatësia politike është më pak e rëndësishme se në të kaluarën, kjo do të ndodh vetëm nëse qytetarët kanë një informacion të bollshëm mbi kandidatët/et dhe partitë mbi të cilët/ata ata do të bëjnë zgjedhjen e tyre. Mund të ketë një mundësi për të inkurajuar zgjedhje më të menduara dhe të informuara, duke siguruar që informacioni mbi kandidatët/et të jetë lehtësisht në dispozicion të votuesve - veçanërisht mbi platformat e partive dhe individëve, të dhënat dhe cilësitë e tjera. Ndërkohë që mund të pritët që subjektet politike të fillojnë fushatat me intensitet të shtuar gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm, subjektet e tjera, të tilla si KQZ-ja dhe organizatat joqeveritare, mund të jenë në gjendje të japin informacion lehtësisht të aksesueshëm dhe të plotë në këtë fushë. Pa një informacion të tillë, me shumë gjasa ata që votojnë mund t'i kthehen përsëri pikës së tyre kryesore të referencës –identiteti dhe përkatësia sipas partive politike.

Ka një nevojë të madhe për informacion mbi kandidatët që garojnë për këshillat bashkiakë.

### **d. Ndikimet e Reformës Administrative Territoriale në motivimin e votuesve**

Ka një lidhje midis Reformës Administrative Territoriale dhe ndjenjave të qytetarëve për të votuar Ditën e Zgjedhjeve. Natyra ekzakte e kesaj lidhjeje është disi komplekse. Duket, për shembull, që njerëzit deklarojnë një ulje të motivacionit për të votuar thjesht për shkak të pakënaqësisë me procesin apo rezultatet e reformës, apo paqartësisë se çfarë kuptimi ka ekzaktësisht reforma për jetën e tyre të përditshme. Nëse paqartësia dhe ndjenjat negative në lidhje me një gjë (reformën) do të përkthehen direkt në qasjet negative ndaj tjetrës (pjesëmarrjes në zgjedhje) është e vështirë për t'u thënë. Pavarësisht pakënaqësisë apo mosnjohjes me kandidatët/et për strukturat e reja qeverisëse,



pjesëmarrësit ende deklaruan një dëshirë për të votuar si dhe arsyet pse do të votojnë dhe pse do të mbështetin partitë dhe kandidatët/et.

Duke gjykuar nga përgjigjet e pjesëmarrësve, ka një shqetësim të madh në lidhje me apatinë e votuesve në komunat që do të jenë në "periferi", p.sh., jo në vendndodhjen e zyrave të qeverisjes vendore. Pjesërisht, kjo është rezultat i paqartësisë se si ata do të marrin shërbime nga qeverisja vendore dhe frikës se ata do të neglizhohen nga komuniteti "bazë", por mund t'i atribuohet edhe mungesës së njohurive rreth kandidatëve/eve, veçanërisht atyre që garojnë për këshillat bashkiakë.

Ekziston një nevojë e qartë për edukimin qytetar lidhur me kompetencat e reja të bashkisë, mënyrës se si do të merren shërbimet, si do të funksionojnë dhe si do të drejtohen (dhe nga kush) njësitë e reja administrative brenda bashkisë, si do të shpërndahen burimet, dhe çështje të tjera të ngjashme. Periudha zgjedhore dhe organet kryesore zgjedhore, si KQZ-ja, nuk janë gjithmonë koha më e mirë dhe institucionet më të përshtatshme për të ofruar një informacion të tillë. Megjithatë, KQZ-ja dhe të tjerët mund të sigurojnë të paktën informacion të detajuar për qytetarët mbi kandidatët/et dhe partitë dhe platformat e tyre, se si ata/ato janë zgjedhur, dhe për çfarë janë zgjedhur për të garuar (kryetar/e apo këshill).

Thënë kjo, ka qenë një pakicë e pjesëmarrësve në grupet e fokusuara që deklaroi disa argumente të mira dhe pozitive për përfitimet e mundshme të reformës, për shembull do të shpenzohen më pak para për administrimin e njësisve të qeverisjes vendore dhe do të grumbullohen burimet. Argumente të tilla duhet të merren në konsideratë kur të ndërtohen fushatat e informimit publik dhe edukimit qytetar mbi sistemin e ri të vetëqeverisjes vendore dhe marrëdhëniet e saj me qytetarët.